AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Kulturës, 2022

16.10.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Kulturës për vitin 2022.

Shikueshmëria e filmave arrin në 39,1% më e lartë në vitin 2022 sesa në 2021

Gjatë vitit 2022 janë realizuar 34 ekspozita në galeritë e artit, ku krahasuar me vitin e kaluar ka pasur rritje të numrit të ekspozitave për 9,7%. Ndërsa, numri i vizitorëve ishte 39 778, ku krahasuar me vitin paraprak ka pasur rënie për (-4,5%).

Shfaqje/premiera dhe ngjarje të tjera në teatro, gjithsej janë realizuar 577. Ndërsa numri i spektatorëve në vitin 2022 ishte 58 288.

Janë shfaqur gjithsej 652 filma të huaj dhe vendorë, ku krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur rritje për 0,5%. Ndërsa numri i shikuesve në këtë vit ishte 270 694. Krahasuar me vitin e kaluar, vërehet rritje e konsiderueshme e numrit të shikuesve për 39,1%.

Viti 2022					
Teatro		Galeri		Kinema	
Shfaqje/premiera dhe ngjarje të tjera	Shikues	Ekspozita	Vizitorë	Filma të huaj dhe vendas	Shikues
577	58 288	34	39 778	652	270 694

Numri i studentëve në fushat e studimit për kulturë

Në fushat e studimit që lidhen me kulturën, në vitin akademik 2022/2023 janë regjistruar 3 851 studentë, të cilët përbëjnë 18,2% të numrit të përgjithshëm të studentëve të regjistruar në këtë vit akademik. Përqindje më e madhe e studentëve të regjistruar ishte te femrat (19,6%), në raport me meshkujt (16,1%) në fushën e kulturës.

Përqindja e femrave që përbëjnë shumicën e studentëve në fushat e studimit që lidhen me kulturën, ishte 64,21%. Përqindja e femrave ishte më e lartë në fushat: “Gazetari dhe informim” (81,4%); “Gjuhë” (78,4%); dhe “Arte” (66,9%). Kurse, ishte më e ulët në fushën “Arkitekturë dhe ndërtim” ku femrat përbëjnë 44,9% të studentëve të regjistruar.



Numri i të punësuarve në fushën e kulturës

Në vitin 2022 janë të punësuar në një aktivitet kulturor ose në një profesion kulturor 3 720 individë, që përbëjnë 0,9% të gjithsej punësimit. Krahasuar me vitin e kaluar, punësimi në kulturë pësoi një ulje me 0,4%.

Shumica e të punësuarve në kulturë janë meshkuj, respektivisht 80,4%. Krahasuar me vitin e kaluar, kjo përqindje është ulur për 0,4%.

Përdorimi i internetit për qëllime kulturore

Në vitin 2022, përdorimi i internetit te femrat ishte kryesisht për blerje online të librave/ revistave/ gazetave (45,4%). Ndërsa, te meshkujt përdorimi i internetit ishte kryesisht për leximin e lajmeve në gazeta/revista (60,7%).

Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas grup-moshave: 25-54 vjeç e përdorin internetin më shumë për të gjitha aktivitetet kulturore; grup-moshat 16-24 vjeç e përdorin internetin më shumë për blerje online të librave/revistave/gazetave rreth 23,3%; dhe grup-moshat 55-74 vjeç e përdorin internetin për leximin e gazetave/revistave rreth 24,2%.

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Për më shumë informata lidhur me publikimin e Statistikave të Kulturës për vitin 2022, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/Culture